



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca Plenare

Seanca nr.2003/28

Prishtinë,më 20 nëntor 2003,në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi Nexhat **DACI**, kryetar i Kuvendit, kurse bashkëkryesues ishte Bajram Kosumi,anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 89 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Në seancën e mëparshme ishte miratuar rendi i ditës i kësaj seance,si vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
2. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për sportin-nr.2003/27;
3. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për kadastër-nr.2003/32;
4. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për transportin rrugor-nr.2003/32;
5. Përgjigjet e ministrave pyetjeve të deputetëve dhe
6. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të 4 dhjetorit 2003.

Në fillim të seancës,kryetari i përshëndeti dhe u dëshiroi mirëseardhje dy deputetëve të Parlamenteit Holandez që ishin të pranishëm në seancë.

Kryetari kërkoi nga deputetët e Kuvendit të procedohej sipas rendit,të ditës të miratuar në seancën e mëparshme.

Hydajet Hyseni kërkoi që pika e tretë e rendit të ditës-Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për kadastrën, të shtyhet për seancën e ardhshme ngase amendamentet u janë shpërndarë deputetëve me vonesë dhe nuk kanë pasur kohë t'i shqyrtojnë.Kjo dukuri po përsëritet vazhdimisht, materialet nuk po vijnë me kohë, por po arrijnë në momentin e fundit. Andaj kjo praktikë,në të ardhmen, duhet të ndërpritet për hirë të cilësisë së punës së Kuvendit.

Kryetari kërkoi edhe mendimet e grupeve të tjera parlamentare lidhur me propozimin e Hydajet Hysenit.

Sabri Hamiti,në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së tha se kjo seancë duhet të procedohet sipas rendit të miratuar të ditës,por për seancat e ardhshme i sygjeroi Kryesisë të mos i vërë pikat në rend dite, nëse nuk janë përgatitur me kohë materialet e nevojshme për shqyrtim.

Bujar Dugolli,në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së,tha se nuk kanë marrë ndonjë vendim paraprak lidhur me rendin e ditës të kësaj seance,por i përkrahu vërejtjetve e parafolësve lidhur me vonesën e shpërndarjes së materialeve.Këto vërejtje le të shërbejnë për Kryesinë që në të ardhmen të mos e propozojë rendin e ditës pa i përgatitë materialet e nevojshme.

Oliver Ivanoviqi tha se e përkrah parafolsin e parë që i theksoi vërejtjet parimore. Kjo do të thotë se, nëse njëherë e ndërpresim këtë praktikë, atëherë do të ndikoi tek ne si Kryesi dhe te komisionet si dhe te ç'do propozues.Ai kërkoi që herave tjera të mos përsëriten lëshime të tilla. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për kadastrën të shyhet për seancën e ardhshme.

Faik Marolli,në emër të Grupit Parlamentar të Komuniteteve të Tjera,tha se kjo seancë duhet t'i vazhdojë punimet sipas rendit të miratuar,kurse për seancat e ardhshme,Kryesia të mos e prpozojë rendin e ditës pa u përgatitur .

Kryetari e hodhi në votë propozimin e Grupit parlamentar të PDK-së dhe rezultati ishte si vijon:

Për -----46;
Kundë-----39;
Abstenime—3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi,me shumicë votash,vendosi që shqyrtimi i dytë i P/ligjit për kadastrin të shtyhet për seancën e ardhshme plenare.

1.Miratimi i procesverbali të seancës së mëparshme.

Procesverbali i seancës së mëparshme u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për sportin-nr.2003/27.

Kryetari i informoi deputetët për raportet dhe për rekomandimet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit funksional për këtë p/ligj. Pastaj i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e radhitura të Komisionit për Kulturë, Rini dhe Sport dhe të koalicionit “Kthimi”.

Kuvendi, me shumicë votash, i miratoi këto amendamente: 1,2,3,4,5,6,8,9,10,11,12,13,16,17,18,19,20,22,23,24,25,26,27,28,29,30,31,32,33,34,35,36,37,38,39,40,41,42,43,44,45,46,47,48,49,50,51,52,53,54,55,56,57,58,60 dhe 61.

Kuvendi nuk i miratoi këto amendamente: 7,14,15,21 dhe 59.

Pastaj kryetari e hodhi në votë P/ligjin si tërësi dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----shumica;
Kundër-----13;
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, e miratoi Ligjin për sportin.

Pastaj, kryetari dha një pauzë prej 20 minutash.

Pas pauzës seancën e kryesoi **Bajram Kosumi**, anëtar i Kryesisë.

3. Shqyrtimi parë i P/ligjit për transportin rrugor –nr.2003/32.

Kryesuesi e ftoi ministrin e Transportit dhe të Postëtelekomit ta arsyetonte para deputetëve këtë p/ligj.

Ministri Zef Morina tha se ky Projektligj është përgjigje ndaj nevojave për një ligj modern për sektorin e transportit rrugor, të udhëtarëve dhe të mallrave.

P/ligj promovon konsolidimin e strukturave përgjegjëse në sektorin e transportit rrugor, bart përgjegjësitë dhe kompetencat përkatëse të subjekteve përgjegjëse në sektorin e transportit rrugor për zhvillimin e transportit të udhëtarëve dhe të mallrave me të cilin ngritet niveli i transparencës dhe i efikasitetit në sektorin e transportit.

Me këtë p/ligj përcaktohen kompetencat e Ministrisë, të komunave, por edhe të drejtat dhe obligimet e operatorëve si ofrues të shërbimit dhe të përdoruesve të këtyre shërbimeve.

Struktura e P/ligjit është e radhitur ëpr këta kapituj:

Në kreun e parë janë dispozitat e përgjithshme që përfshijnë lëndën e rregullimit, qëllimin dhe fushën e zbatimit të tij; përkufizimet, përgjegjësitë e institucioneve të vetëqeverisjes, përgjegjësitë e operatorëve të transportit që ushtrojnë këtë veprimtari në territorin e Kosovës; mënyrën dhe kushtet e dhënies së liçencave dhe lejeve operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor;

Në kreun e dytë normohet transporti rrugor i udhëtarëve, precizohen llojet e transportit rrugor të udhëtarëve. Në mënyrë të veçantë definohen kompetencat dhe përgjegjësitë në nivel qendror dhe lokal, përkatësisht duke përcaktuar se Ministria është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e transportit të rastit të udhëtarëve me autobus, transportit ndërurban të udhëtarëve me autobus, si dhe të transportit ndërkombëtar të udhëtarëve me autobus.

Në kreun e tretë normohet transporti rrugor i mallrave, përcaktohet mënyra dhe kushtet e kryerjes së këtij lloji të transportit, si: transporti i mallrave për nevoja personale dhe transporti i mallrave me qera dhe me pagesë. Liçencat jepen për një periudhë pesëvjeçare, ndërsa për transportin e jashtëm Ministria përcakton dhe shkëmben numër të nevojshëm lejesh për një vit me organet kompetente të shteteve tjera.

Në kreun e katërt normohet mbikëqyrja dhe kontrolli në transportin rrugor, definohen mënyra dhe kushtet e mbikëqyerjes dhe të kontrollimit për zbatimin e këtij ligji dhe akteve tjera të nxjerra në bazë të tij, kompetencat e inspektorit të transportit me rastin e kontrollimit të operatorëve dhe masat që do t'i ndërmarrë në qoftë se konstaton se transporti nuk është duke u zhvilluar në pajtim me dispozitat ligjore.

Me dispozitat ndëshkimore përcaktohen kundërvajtjet administrative dhe masat e gjobitjes, kurse me dispozitat kalimtare dhe përfundimtare parashihet hyrja në fuqi e ligjit. Në fund ministri Zef Morina i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë p/ligj.

Pastaj **kryesuesi** e hapi diskutimin për shqyrtimin në parim të këtij p/ligji.

Mahir Jakgjillar, në emër të Komisionit Funksional, tha se e përkrah në parim këtë p/ligj, por ka disa vërejtje, që duhet të merren parasysh gjatë shqyrtimit në komisionet parlamentare.

Në P/ligj nuk ofrohen zgjidhje për transportin e taksive-kombi busëve-8+1; nuk janë të saktësuara kushtet për licencim në nenin 15; ka mospërputhje ndërmjet neneve 22.6, 11.2 dhe 26.1 me të cilat rregullohen dhënia dhe ndalimi i vijave me qera dhe për bartjen e obligimeve; në aotomjetet e transportit publik nuk duhet të lejohet transporti i personave që vuajnë nga sëmundjet ngjitëse, nën ndikimin e alkoolit, të ngarkotikëve etj.

Në P/ligj duhet të parashihen edhe lista e akteve nënligjore që duhet t'i nxjerrë Ministria, si dhe afat i nxjerrjes së tyre.

Këto dhe vërjetje të tjera gjatë shqyrtimit të p/ligjit, me anë të amendamenteve, duhet të inkorporohen në P/ligj, që është shumë i rëndësishëm për transportin rrugor në Kosovë.

Ilmi Ahmeti, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së e përkrahu në parim. Theksoi se Kosovës i ka munguar një ligj i tillë, që rregullon këtë lloj të transportit, sidomos tash kur janë shtuar nevojat për transportin rrugor, të njerëzve dhe të mallrave dhe për arsye të mungesës së transportit hekurudhor. Ky Projektligj është mjaft përmbajtësor, mjaft i qartë dhe në mënyrën më të mirë zgjidhë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me këtë lloj të

transportit.Çështjet e transportit të jashtëzakonshëm, të transportit të veçantë dhe të transportit me kombibus do të duhej të rregulloheshin me nene të veçanta, sidomos këto dy të fundit - transporti i veçantë që është me interes për Kosovën, si transporti i mallrave me vlerë,i pasurive shtetërore e tjera. Çështje mjaft e rëndësishme është transporti i udhëtarëve me kombibus, e që ky Projektligj do ta zgjidhë në bashkëveprim me pushtetin lokal, ku komunave u jepen mundësi ta rregullojnë transportin e udhëtarëve dhe të mallrave në nivel lokal dhe në këtë kuadër do të zgjidhet ky lloj transporti me këto lloj automjetesh.

Sala Ahmetaj,në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së,e përkrahu në parim këtë p/ligj.Shikuar nga aspekti përmbajtësor dhe strukturor, theksoi ajo,P/ligji është hartuar mirë dhe me një gjuhë të kuptueshme relativisht të kënaqshme.

Ndër vërejtjet më serioze që do t'ia bënim këtij ligji janë te roli i Ministrisë në sektorin e transportit dhe funksioni i saj. Kemi vënë re se kompetencat kryesore për çështje parësore dhe më të rëndësishme në këtë Projektligj i ka ministri. Vetëm një njeriu do të lejojë mundësinë për byrokratizim dhe keqpërdorim.

Këtu ka të bëjë, për shembull me nenet 11, 16, 20, 22.4, 47.2, 58.2, e shumë gjëra të tjera në P/ligj janë thënë të përgjithsuara, pa saktësime dhe pa kritere të precizuara.

Naim Maloku, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës,e përkrahin këtë p/ligj,por i paraqiti disa vërejtje dhe propozime,që gjatë fazës së shqyrtimit,me amendamente duhet të inkorporohen në p/ligj.

Neni 39.2 parasheh mënyrën e transportit të udhëtarëve me, të ashtuquajturit kombibus ose taksi 8 plus 1, që me këtë ligj është kompetencë e komunës. Mirëpo, ky nen bie ndesh me nenin 42, ku, për shembull, drejtuesit e automjetit taksi nuk mund të qëndrojnë e as të marrin udhëtarë në territorin e komunës, ku nuk janë të regjistruar.

Neni 39.2, është shumë interesant se vjen në shpërputhje edhe me nenin 41 – 21.2, pika e fundit ku thuhet: Taksi nuk mund të shfrytëzohet vendndaljet e dedikuara për autobus. Transportin ndërkombëtar, që është rregulluar me nenet 53 deri 60. Por, këtu mungojnë lejet transite, të ashtuquajtura, jo vetëm të transportit jashtë Kosovës, siç është me nenin 53 nën a) për transport brenda Kosovës, për transport jashtë Kosovës dhe duhet të jetë edhe për transportin transit nëpër territorin e Kosovës.

Duhet të rregullohet transporti i mallrave të veçanta, jo mallrave të rrezikshme .mallrave të rrezikuara, si është – bartja e të hollave, e pasurive prej një banke në bankën tjetër.

Duhet të parashihet që qarkullimi i automjetet me ngarkesë të rëndë,të bëhet gjatë natës, në mënyrë që të lirohet transporti rrugor në kohën kur është i mbingarkuar .

Faik Marolli, në emër të Grupit Parlamentar të Komuniteteve të Tjera, theksi se ky P/ligj është i qartë,i kuptueshëm dhe ka rëndësi të veçantë për zhvillimin ekonomik të Kosovës.E përkrahu në parim dhe gjatë shqyrtimit të tij në komisione do të korrigjohet dhe plotësohet me amendamente.

Rangjell Nojkiq theksoi se Grupi Parlamentar i Koalicionit «Kthimi» i ka tri vërejtje parimore, dhe nëse ato nuk evitohen , atëherë ky ligj do të jetë bllokadë e komunikacionit e jo rregullim i tij.

Këto tri vërejtje i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Para së gjithash , për arsye se me këtë ligj janë uzurpuar disa të drejta të rezervuara për PSSP dhe janë në

llogarin e Ministrisë. Vërejtja e dytë është se në grupin e punuës për hartimin e këtij ligji nuk ka marrë pesë asnjë ekspert nga komuniteti serb.

Vërejtja e tretë është se te tri verzionet e këtij ligji ndryshojnë rrënjësisht sepse nuk nuk janë të përkthyer në mynërë adekuate.

Ai propozoi që ky P/ligj të tërhiqet nga procedura deri sa të mos zgjidhen këto probleme. Koalicioni “ Kthimi “ nuk do të votojë për këtë ligj në parim.

Ibush Jonuzi tha se nenit 23 pika 4 duhet t’i shtohet “për raste urbane të jenë kompetentë edhe organet komunale”, në mënyrë që të përcillet më lehtë dhe t’u bëhet qytetarëve e mundshme të kenë shërbime personale më të lehta.

Po të njëjtit nen pika 5 duhet t’i shtohet “organi komunal kompetent të bëjë regjistrimin dhe evidentimin e veprimtarive që i bën në këtë lëmi”.

Komunikacioni rrugor në nivelin komunal duhet të rregullohet me një nen të veçantë

Sabit Rrustemi i paraqiti disa vërejtje që gjatë fazës së shqyrtimit,me anë të amendamenteve duhet të inkorporohen në p/ligj,siç janë: Çështja e parë, është pikërisht çështja e gjuhës,në të gjitha p/ligjet, nuk u duhet vetëm një lekturë, por u duhet edhe një redakturë e mirë nëpër të gjitha ato. Çështja tjetër është çështja e transportit rrugor të udhëtarëve. Tepër është përforcuar transporti i operatorëve publikë, ndërsa është cunuar transporti i operatorëve privatë. Ne kemi taksi që vijnë edhe prej shteteve të tjera në Kosovë dhe nuk i nënshtrohen asnjë licencimi, ndërsa tanëve u mohohet e drejta që të lëvizin nga Gjilani në Viti, në Kamenicë, në Prishtinë, në Ferizaj, e tjera.Transporti i veçantë,përveç nxënësve të shkollave fillore,duhet t’i përfshijnë edhe nxënësit e shkollave të mesme.

Në fund kryesuesi e hodhi në votë këtë p/ligj dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----shumica;
Kundër----- 13;
Abstenime-----0.

Kryesusei konstatoi se Kuvendi i Kosovës,me shumicë votash,e miratoi në parim P/ligjin për transportin rrugor dhe i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin Funksional që ta shqyrtojnë këtë p/ligj brenda tri javësh dhe t’ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

4. Përgjigjet e ministrave pyetjeve të deputetëve.

4.1 **Ministri Zef Morina** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Ismajl Kurteshi** lidhur me pengimin e ndërtimit të objekteve pa leja në afërsi të rrugëve magjistrale dhe për shenjzimin e rrugëve.

4.2 **Ministri Goran Bogdanoviq** iu përgjigj gojarisht pyetjes së deputeti **Ismajl Kurteshi** lidhur me furnizimin me farë të drithit.

5. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të 4 dhjetorit 2003.

Muhamed Kelmendi kërkoi që çështja e privatizimit të radhitet si çështje e ngutshme për seancën e ardhshme, në të cilën Qeveria dhe AKM-ja do t'i infomojnë deputetët për rrëjedhën e privatizimit.

Alush Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, kërkoi që çështja e privatizimit të radhitet në njëren nga seancat e ardhshme të Kuvendit.

Fatmir Rexhepi kërkoi që Projektbuxhet i Kosovës për vitin 2004, si dhe procesi i privatizimit, për shkak të rëndësisë që kanë, të shqyrtohen në seanca të veçanta të Kuvendit.

Hydajet Hyseni theksoi se Grupi Parlamentar i PDK-së, më parë ka kërkuar që procesi i privatizimit të shqyrtohet në Kuvend.

Kryesuesi tha se Kryesia e Kuvendit do t'i marrë parasysh këto kërkesa para se do t'ia propozojë Kuvendit rendin e ditës së seancës tjetër plenare.

Kuvendi, me propozimin e Kryesisë, e miratoi rendin e ditës për seancën plenare të datës 4 dhjetor, si vijon:

1. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për kadastër;
2. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për produktet dhe pajisjet medicinale dhe
3. Shqyrtimi i P/buxhetit të Kosovës për vitin 2004.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën plenare në orën 13:15 minuta.

Sekretaria e Kuvendit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës

Akademik Nexhat DACI